



**VENDIM**

*Nr. 112, Datë 08.07.2016*

**PËR PËRCAKTIMIN E TË LICENCUARIT TË NGARKUAR ME  
DETYRIMIN E SHËRBIMIT UNIVERSAL PËR TREGUN E ENERGJISË  
ELEKTRIKE DHE PËRCAKTIMIN E KUSHTEVE PËR USHTRIMIN E  
DETYRIMIT TË SHËRBIMIT UNIVERSAL**

Në mbështetje të neneve 16; 19; 47; 83 dhe 85 të Ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” VKM Nr. 244, datë 30.03.2016, “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licensuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike” dhe nenit 26 të Rregullave të Organizimit, Funksionimit dhe Proçedurave të ERE-s, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i ERE, në mbledhjen e tij të datës 08.07.2016, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoritë Teknike mbi përcaktimin e të licensuarit të ngarkuar me detyrimin e shërbimit universal si dhe kushtet për ushtrimin e detyrimit të shërbimit universal,

**Konstatoi se:**

- ERE në mbështetje të neneve 19 gërma “d” dhe 83 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike” vendos ndaj të licensuarve detyrimin e shërbimit universal të furnizimit, në përputhje me parashikimet e neneve 47 dhe 85 të ligjit, sipas kushteve të përcaktuara nga ERE.
- Këshilli i Ministrave me vendimin Nr. 244, datë 30.03.2016, ka miratuar “Kushtet për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të

*licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”.*

- Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 244, datë 30.03.2016, “Kushtet për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike” përcakton në nenet 2 dhe 4 “Detyrimi i shërbimit publik ndaj një të licencuari vendoset nga ERE”

Për gjithë sa më sipër Bordi i ERE,

### **Vendosi:**

1. Detyrimi i shërbimit universal të furnizimit të energjisë elektrike i vendoset shoqërisë OSHEE sh.a/FSHU, sipas përcaktimeve të nenit 83 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike” dhe kushteve të përcaktuara në këtë vendim.
2. Kushtet për ushtrimin e detyrimit të shërbimit universal për tregun e energjisë elektrike bashkëlidhur këtij vendimi përcaktojnë të drejtat dhe detyrimet për të siguruar përmbushjen e detyrimit të shërbimit universal të energjisë elektrike.
3. Drejtoria Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë palët e interesuara për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI I ERE**  
**Petrit AHMETI**